

RAPORTI I MONITORIMIT TË MEDIAVE

Zgjedhjet e parakohshme
për Kuvendin e Kosovës

Përgatitur nga: Lëvizja FOL, në kuadër të misionit vendor për
vëzhgimin e zgjedhjeve "Demokracia në Veprim"

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
METODOLOGJIA	6
KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT GJATË ZGJEDHJEVE.....	7
TË DHËNAT E PËRGJITHSHME NGA MONITORIMI	9
Kronikat zgjedhore.....	9
Debatet televizive	10
Struktura dhe përfshirja në debatet televizive	12
Monitorimi i faqeve zyrtare të Facebook-ut	13
GJETJET INDIVIDUALE NGA MONITORIMI I TELEVISIONEVE	14
RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS (RTK)	14
Kronikat zgjedhore.....	14
Debatet televizive	15
Struktura dhe përfshirja në debatet televizive	16
KOHAVISION	17
Kronikat zgjedhore.....	17
Debatet televizive	17
Struktura dhe përfshirja në debatet televizive	18
T7	19
Kronikat zgjedhore.....	19
Debatet televizive	19
Struktura dhe përfshirja në debatet televizive	

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Monitorimi i mediave gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës (27 maj – 6 qershor 2026) analizon kronikat zgjedhore, debatet televizive dhe komunikimin e subjekteve politike në rrjetin social Facebook. Qëllimi i monitorimit është të vlerësojë nivelin e transparencës, paanshmërisë dhe qasjes së barabartë në mbulimin mediatik, si dhe cilësinë e debatit publik gjatë fushatës zgjedhore.

KRONIKAT ZGJEDHORE

Gjatë periudhës së monitorimit janë transmetuar mbi 11 orë kronika zgjedhore. PDK ka pasur mbulimin më të madh mediatik (24%), e ndjekur nga LDK (23%), LVV (22%) dhe AAK (21%), ndërsa PSD dhe Lista Serbe kanë pasur dukshëm më pak hapësirë mediatike.

Lloji i emisionit	Pjesëmarrja e partive
Me një subjekt/kandidat - 94	PDK - 56
Vetëm me analistë - 45	LDK - 49
Shumë subjekte - 15	AAK - 36
Debat në mes dy subjekteve/ kandidatëve - 9	PSD - 27
Format tjetër - 8	LVV - 23

Sa i përket përfaqësimit gjinor në debatet televizive, monitorimi tregon një dominim të dukshëm të burrave në raport me gratë. Nga gjithsej 200 paraqitje të përfaqësuesve politikë, 162 ose 81% kanë qenë burra, ndërsa vetëm 38 ose 19% kanë qenë gra. Këto të dhëna tregojnë se gratë kanë pasur dukshmëri dukshëm më të ulët në de-

batet zgjedhore, duke pasur më pak mundësi të prezantojnë programet, qëndrimet dhe prioritetet e tyre politike para publikut. Si

Struktura dhe përfshirja në debatet televizive

Në Kanal 10 gjatë fushatës zgjedhore janë transmetuar 24 debate televizive, ku kanë dominuar intervistat me nga një kandidat/subjekt me 16 emisione, ndërsa ato me analistë 7 emisione dhe vetëm një emision me shumë subjekte

LVV dhe PDK kanë marrë pjesë në 5 debate, ndërsa LDK dhe AAK në nga 4 debate.

Lloji i emisionit	Pjesëmarrja e partive
Me një subjekt/kandidat - 16	LVV - 5
Vetëm me analistë - 7	PDK - 5
Shumë subjekte - 1	LDK - 4
	AAK - 4
	PSD - 3

Nga 21 pjesëmarrës në Debatet televizive, vetëm 2 kanë qenë gra



